



Pranim / Dorezuar Priljevit / Priljevit Received / Delivery	05.01.2024	viti god Year	4
Organ / Shënia Organ / Jedimica Org / Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKIC	100/2024		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1429/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1429/2023, të datës 21.11.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit nën shenjën ASHNA-KD 0003/2023, të datës 24.10.2023, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike-administrative “Masë Disiplinore-Largim nga shërbimi publik”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.01.2024, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1429/2023, të datës 21.11.2023, të parashtruar nga ankuesja.
- II. Pala ankuese udhëzohet mbi drejtën e inicimit të kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesja (tutje vetëm ankuesja), më datë 21.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1429/2023, kundër Vendimit ASHNA-KD 003/2023, të datës 24.10.2023, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (tutje ASHNA), për shkak të: aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ndërsa, kjo e fundit, më datë 05.12.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja

sepse:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me Nr.Prot.0058 të datës 27.03.2017, ushtron pozitën e punës “*Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm*” në Departamentin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Me datë 30.08.2023 përmes e-mailit zyrtar, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, ka parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses me arsyetimin se ankuesja ka bërë shkelje të rënda disiplinore si: mos përmbushje të detyrave të punës, moszbatim të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe shkelje të detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Tutje, Komisioni Disiplinor i ASHNA-së, me Vendimin ASHNA-KD 003/2023, të datës 26.10.2023, ka gjetur përgjegjëse ankuesen për shkeljet e rënda disiplinore të parapara në nenin 46 paragrafët 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “Largim nga shërbimi publik”, e kundër të cilit vendim, ankuesja ka ushtruar ankesë në Këshillin e Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Duke ju referuar nenit 99 paragrafit 6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i aplikueshëm nga data 26.09.2023, ku përcaktohet se: *Procedurat e rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave të filluara dhe të papërfunduara në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar çështjet përkatëse*, Kolegji konstaton se procedura disiplinore ndaj ankueses ka filluar me datë 30.08.2023, pra në kohën ku ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore ka përfunduar kjo procedurë, andaj edhe trajtimi i kësaj çështje administrative në kuptimin e plotësimin të kërkesave të pranueshmërisë së ankesës do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit 06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Rrjedhimisht, nisur nga konstatimi si më sipër, Kolegji i ‘u referua Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik gjegjësisht nenit 2, më të cilin është përcaktuar se: “... 2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës. 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike...” si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar edhe në konfirmimet e datës 19.11.2021 dhe 04.01.2024, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si njësi përgjegjëse për deklarimin e statusit të zyrtarëve publike siç ishte përcaktuar me nenin 83 paragrafin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka pasur statusin e nëpunësit të shërbimit publik, kështu që, në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil,



dhe si rrjedhojë Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1429/2023, të datës 21.11.2023 të parashtruar nga ankuesja, pasi që e njëjta nuk ka pasur statusin e nëpunësit civil me rastin e inicimit të procedurës disiplinore.


Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se nëpunësi i shërbimit publik, fillimisht duhet të ankohet tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Duke marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës pranë organit të punësimit përkatësisht te Komisioni për Ankesa i ASHNA-së, pala ankuese udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente, pasi që lënda nuk mund të bartet të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1429/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

